



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 17.06.2025
Numër Protokolli: 4118/2025

A.nr.771/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.771/2025, të datës 30.04.2025, të parashtruar nga ankuesja M.Rr, kundër organit të punësimit: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*transferim sipas ristrukturimit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 17.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.771/2025, e datës 30.04.2025, e parashtruar nga ankuesja M.Rr.

II. Mbetet në fuqi Vendimi MMPHI-267/2025, i datës 18.03.2025, i Drejtorit të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, Ministria e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, M.Rr (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), më datë 30.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit MMPHI-267/2025, të datës 18.03.2025, të Drejtorit të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, Ministria e Punëve të Brendshme, lidhur me transferimin e saj për shkak të ristrukturimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, më datë 13.05.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (tutje MMPHI), ndërsa, kjo e fundit, më datë 15.05.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 2859/2025 të datës 30.04.2025 të ankueses drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimit MMPHI-267/2025, të datës 18.03.2025, të Drejtorit të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, Ministria e Punëve të Brendshme; Emailin e datës 0-1.04.2025 nga F.B për ankuesen; Vendimin e datës 15.12.2021; Akt Emërimin e datës 01.10.2024; Kopjen e ID-së së ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 13.05.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 15.05.2025; Vendimin me Nr. 2392/2024 i datës 29.11.2024 për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit në MMPHI; Raportin e punës të datës 03.03.2025 të Komisionit të Ristrukturimit; Përshkrimin e punës për pozitën Zyrtar Për pasuri; Diplomat e ankueses, Vendimin me numër protokollit 3950/2025 të datës 11.06.2025 për zgjatjen e afatit të vendosjes së ankesës së ankueses.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesja është e punësuar në pozitën *Zyrtare për Pasuri*, në Divizionin për të Hyra dhe Pasuri, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Tutje sipas Vendimit me Nr.073/2024 të datës 29.03.2024, të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, është miratuar Rregullorja (ZKM) Nr.08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me ç'rast procesi i organizimit të MMPHI, është pasuar me shuarje të pozitive, ndryshime në emërtime të pozitive përkatëse si dhe ndryshime në përshkrimin e detyrave dhe kritereve të punës për pozita të caktuara.

Në kuadër të përgjegjësiive ligjore, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin me Nr.2392/2024, të datës 29.11.2024, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për MMPHI, ku ky i fundit, më datë 03.03.2025, ka miratuar Raportin përfundimtar lidhur me procesin e ristrukturimit në MMPHI, ashtu që ankuesja është propozuar të transferohet nga pozita Zyrtare e Pasurisë, në pozitën Zyrtare për Pasuri sipas klasës profesional 2. Ndërsa, në zbatim të rekomandimeve të Komisionit të Ristrukturimit, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në MPB, më datë 18.03.2025, ka nxjerr Vendim MMPHI-267/2025, me të cilin ankuesen e ka transferuar nga pozita Zyrtare e Pasurisë në pozitën Zyrtare për Pasuri në Divizionin e të Hyrave dhe Pasurisë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmerinë e Vendimit MMPHI-267/2025, të datës 18.03.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, i pranuar nga ankuesja më datë 01.04.2025, duke pretenduar se i plotëson kushtet të transferohet në pozitën Zyrtare e Lartë e Pasurisë, apo në një pozitë ekuivalente si zyrtare e lartë. Kërkon që të aprovohet ankesa, të anulohet vendimi i kontestuar dhe procedura e ristrukturimit të kthehet në pikën zero.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses lidhur me të drejtën e saj të sistemimit për shkak të riorganizimit, Kolegji i Këshillit, iu referua dispozitave të nenit 66 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunëse/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion; 2.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësja/i; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet komisioni i ristrukturimit që shqyrton*

mundësitë e sistemimit të çdo nëpunëse/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunëses/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës. 4. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia përgjegjëse në bazë të propozimit të komisionit. 5. Nëpunësja/i mund të refuzojë transferimin vetëm për arsyt e parashikuara në paragrafin 3. të nenit 63 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera, përbën shkak për lirimin nga shërbimi civil. 6. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3. të këtij neni, drejtohet nga njësia përgjegjëse dhe në të bëjnë pjesë përfaqësuese të institucioneve të parashikuara në nën-paragrafët 2.1., 2.2., 2.3. apo 2.4. të këtij neni, sipas rastit ku bëhet ristrukturimi përkatës..... dhe si rrjedhojë bazuar në frymën e këtyre normave juridike, Kolegji i Këshillit vlerëson së ristrukturimi është proces i ndryshimit të organizimit të institucionit si rezultat i ndryshimit të misionit dhe fushëveprimit të institucionit, bashkimit apo fuzionimit të dy apo me shumë institucioneve, shuarjes së institucionit-eve apo shuarjes së funksioneve të caktuara të institucionit përkatës, dhe rrjedhimisht si rezultat i riorganizimit të institucionit mund të ketë ndryshime të vendeve të punës, shkurtime (shuarje) të vendeve të punës apo ndryshime të kriterëve të vendeve të punës. Nisur nga ky fakt, Kolegji konstaton se si rezultat i organizimit të brendshëm të MMPHI i materializuar më Rregulloren ZKM-Nr.08/2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pozita e ankueses nuk është shuar apo ndryshuar dhe se Divizioni i të Hyrave dhe Pasurisë është paraparë si njësi organizative ndërsa në strukturën e tij janë aprovuar dy pozita Zyrtar për Pasuri, më klasë profesional 2.

Duke qenë se pozita e ankueses nuk është shuar sipas Rregulloren ZKM-Nr.08/2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, në kuptim të dispozitave të ligjit material, vlerëson se ankuesja vetëm është propozuar nga Komisioni i Ristrukturimit të transferohet në pozitë të njëjtë sipas Aktit të Emërimit të datës 01.10.2024, dhe në divizion të njëjtë, pa pasur nevojë të propozoj transferimin në ndonjë pozitë tjetër për faktin se pozita e saj nuk ka pësuar asnjë lloj ndryshimi.

Rrjedhimisht duke qenë së ankuesi është transferuar në kategori të njëjtë gjegjësisht në klasë të njëjtë, Kolegji i Këshillit, vlerëson së ankueses nuk i është cenuar ndonjë e drejtë e tij nga marrëdhënia e punës si rezultat i ristrukturimit, dhe meqenëse nuk ekzistojnë asnjëra nga arsyt ligjore për refuzim të transferimit siç parashihet me nenin 66 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ndërlidhur me nenin neni 63 paragrafi 3 i këtij ligji ku është ka përcaktuar se: “3. Transferimi i përkohshëm i nëpunëses/it civil, është vendim i drejtueses/it më të lartë të institucionit dhe mund të refuzohet nga shërbyesja/ i civil në këto raste: 3.1. kur gjendja e saj/tij shëndetësore, dëshmuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur; 3.2. nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë së njëqind (100) km nga vendbanimi i nëpunëses/it civil”, Kolegji konstaton se nuk kanë mbështetje ligjore pretendimet ankimore të ankueses si në ankesë.

Kolegji i Këshillit mbi bazën e konstatimeve si më lartë, vlerëson së Komisioni i Ristrukturimit në rastin e ankuesit ka vepruar në pajtim me 66 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenet 13, 14 dhe 15 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, dhe se Vendimi MMPHI -267/2025 i datës 18.03.2025, i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, është nxjerr në pajtim me nenin 66 paragrafi 4 Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 14 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil dhe po ashtu akti kontestuar përmban elementet të aktit administrativ të përcaktuar me nenin 47 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Për sa më sipër, e duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.771/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses M.Rr;*
- *Njësisë për Burime Njerëzore në MMPHI; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*